



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, më 16 korrik 2012  
Nr. ref.: RK/281/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rastin Nr. KI 159/11**

Parashtruesi

**Baton Morina**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës  
së Kosovës Pn. nr. 530/2011, të 13 tetorit 2011**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Cukalovic, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Baton Morina me vendbanim në Gjakovë, i përfaqësuar nga z. Sokol Dobruna, avokat.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Vendimi gjyqësor i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Pn. nr. 530/2011, i 13 tetorit 2011, të cilin përfaqësuesi i parashtruesit e ka pranuar më 19 tetor 2011.

## **Objekti i çështjes**

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pn. nr. 530/2011 të 13 tetorit 2011, që ka të bëjë me kryerjen e një vepre penale.

## **Baza juridike**

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: "Kushtetuta"), nenin 47 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 28 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

## **Procedura në gjykatë**

5. Më 9 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi Kërkesën në Gjykatë
6. Më 17 janar 2012, Kryetari caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare Raportuese dhe Kolegjin Shqyrtues në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.
7. Më 19 janar 2012 Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës dhe kërkoi dokumentacion shtesë. Të njëjtën datë Gjykata gjithashtu e njoftoi Gjykatën Supreme dhe Gjykatën e Qarkut në Prishtinë për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 13 shkurt 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të Kërkesës dorëzoi dokumentacionin e kërkuar nga Gjykata.
9. Më 2 korrik 2012, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues, që e zëvendëson gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj si dhe e caktoi Kolegjin e ri Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues) që e zëvendëson gjyqtaren Iliriana Islami, Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
10. Më 13 korrik 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 23 qershor 2006 Gjykata e Qarkut në Pejë, (Aktgjykimi P. nr. 80/2006), shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi për veprën penale “vrasje e rëndë në ndihmë, e në tentativë”.
12. Kundër këtij aktgjykimi, përfaqësuesi i parashtruesit (avokat mbrojtës) parashtroi ankesë duke argumentuar se kishte pasur shkelje esenciale të dispozitave penale, shkelje e ligjit penal, vërtetim i gabuar dhe jo i plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për shqiptimit të masës së dënimit dhe gjithashtu kishte kërkuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar, si dhe kthimin e çështjes për rigjykim në shkallën e parë.
13. Me 23 janar 2007 Prokurori Publik i Qarkut në Pejë propozoi që ankesat të refuzoheshin si të pabazuara.
14. Më 19 prill 2007 Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin AP. nr. 582/2006, me ç'rast miratoi ankesën e Prokurorit të Qarkut në Pejë dhe ia rriti dënimin.
15. Parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Supreme, parashtroi *kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë* duke pretenduar se ishin bërë shkelje e të drejtave të mbrojtjes, sepse ai pretendon se kërkesat e tij të paraqitura në ankesë nuk u morën parasysh nga Gjykata Supreme.
16. Më 31 dhjetor 2007 Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Pkl nr. 78/2007) e refuzoi si të pabazuar “kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë”, duke vlerësuar që shkalla e parë dhe shkalla e dytë kishin konstatuar drejt faktet. Për më tepër Gjykata Supreme konkludoi se nuk kishte pasur shkelje thelbësorë të procedurës penale dhe se dispozitat e ligjit penal ishin zbatuar drejt.
17. Më 29 janar 2011, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata e Qarkut në Pejë që çështjet objekt të kërkesës përfshirë rihapjen e procedurës penale duhet të vendosen nga ana e gjyqtarëve të EULEX-it.
18. Më 13 shtator 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë, hodhi poshtë kërkesën për rishikimin e procedurës penale të përfunduar me Aktgjykimin e formës së prerë (P.nr. 80/2006 të 23 qershorit 2006) me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur baza ligjore për rishikimin e procedurës penale dhe se nuk ishin prezantuar fakte dhe prova të reja.
19. Më 13 shtatorit 2011, kundër Aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Gjykatën Supreme, duke pretenduar se kishte pasur cenime të rënda të dispozitave të procedurës penale, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të ligjit penal. Parashtruesi i kërkesës propozoi që Gjykata Supreme ta anulojë aktvendimin e atakuar dhe çështjen t’ia kthejë shkallës së parë për rishqyrtim dhe rivendosje. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkoi përjashtimin e Prokurorit të Qarkut në Pejë, për shkak të dyshimeve subjektive që prokurori kishte me disa nga dëshmitaret.

20. Më 13 tetor 2011 Gjykata Supreme (Pn. nr. 530/2011) refuzoi si të pa bazë ankesën në mungesë të paraqitjes së fakteve dhe provave të reja dhe konkludoi se nuk kishte bazë të mjaftueshme ligjore për rishikimin e procedurës.
21. Përfundimisht, më 9 nëntor 2011, parashtruesi i kërkesës parashtroi këtë kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme Pn. nr. 530/2011 të 13 tetorit 2011.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme i janë shkelur të drejtat kushtetuese të garantuara me Nenin 31 [E Drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], Nenin 32 [E drejta për mjete juridike], Nenin 33 [Parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në rastet penale]; dhe Nenin 53 [Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut] të Kushtetutës.

### **Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës**

23. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kriteret procedurale për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, e që specifikohen më tutje në Ligj dhe Rregullore të punës së Gjykatës.

24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 (1) të Kushtetutës që përcakton se

*“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”*

25. Po ashtu neni 48 i Ligjit parashikon që:

*Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.*

26. Përfundimisht, Gjykata ende i referohet rregullit 36 të Rregullores së Punës që përcakton se:

*“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:  
c) Kërkesa është qartazi e bazuar:*

27. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka sqaruar se si dhe pse aktgjykimi i Gjykatës Supreme ia ka cenuar të drejtat kushtetuese të garantuara me nenet 31, 32, 33 dhe 53. Thjesht mospajtimi me aktgjykimin së bashku me numërimin e disa dispozitave kushtetuese nuk mjafton për të ngritur rast për shkelje kushtetuese.
28. Nuk është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese që të vlerësojë ligjshmërinë dhe saktësinë e provave të vendimeve të nxjerra nga gjykatat e rregullta përveç nëse ka

argumente bindëse dhe prova që çojnë në konkludime bindëse se një aktgjykim i tillë është nxjerrë në mënyrë dukshëm të padrejtë dhe të arbitrare.

29. Në juridiksionin e Gjykatës është që të analizojë shkeljet e të drejtave kushtetuese dhe të vlerësojë nëse procedurat, në tërësinë e tyre kanë qenë të drejta dhe në pajtueshmëri me Kushtetutën, Pra, Gjykata Kushtetuese nuk është shkallë e katërt e apelit, nuk ka juridiksion për të përsëritur procedurat gjyqësore apo në ndonjë mënyrë të zëvendësojë aktgjykimin e Gjykatës Supreme me konstatimet e veta.
30. Rrjedhimisht, Gjykata gjen se Kërkesa e Parashtruesit nuk i përmbush kërkesat për pranueshmëri të parapara në dispozitat e kombinuara të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe të rregullit 36.2 (b) dhe (d) të Rregullores së Punës, prandaj si e tille, kërkesa konsiderohet është qartazi e pabazuar dhe duhet të hedhet poshtë si e papranueshme (*shih Aktvendim për Papranueshmëri Lënda nr. KI 13/09, Sevdail Avdyli kundër Aktgjyimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 11 shtator 2006 dhe Aktgjyimit të Gjykatës Supreme A. Nr. 533/2006 të datës 2 dhjetor 2006, 17 qershor 2010*).
31. Rrjedhimisht, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 56.2 të Rregullores së Punës, kërkesa është e papranueshme.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës, nenin 46 të Ligjit, rregullin 36.2 (b) dhe (d), rregullin 56.2 të Rregullores së punës, më 13 korrik 2012, njëzëri

### **VENDOSI**


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Gjyqtari raportues**



Almiro Rodrigues

**Kryetar i Gjykatës Kushtetuese**



Prof. Dr. Enver Hasani